Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **-III-** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datën **19.03.2025 (e Mërkur),** duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal te objekti i vjetër i komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës afatgjat.**
   **mbi aktivitetet e prokurimit për vitin 2024.**
4. **Raport vjetor nga zyra e prokurimit për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2024.**

**Viti, më 12.03.2025**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL
## NGA MBLEDHJA E DYTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **19.02.2025 (e martë),** në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal të Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i kuvendit komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Majlinda Shabani, znj.Zyrafete Rama, znj.Zejnepe Osmani. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se ka anëtarë për kourum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së! Pra, materialin e keni marrë me kohë, para se me hy në rend të ditës hapim diskutim. Njëher dhe ju falenderoj për punën, angazhimin gjatë këtij muaji për fushatën që ka qenë, një fushatë pothuajse jashtëzakonisht e mirë në Viti. Urojmë që të shkoj mirë dhe formimi i institucioneve në vendin tonë. Para se me hapë diskutimin, ju kërkoj falje këshilltarëve komunal për seancën soleme, të cilët nuk e kanë pas vendin e vetë ku të ulen, ka qenë një qrregullim kësaj radhe.

**z.Jakup Demiri:** Ka pas me ardhë dhe një listë e projekteve të cilat nuk kanë pranim teknik, por pasi që qenkan raporti kryetarit dhe pasqyrat në të njëjtën kohë atë me shty për muajin tjetër.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat, materialin e keni marrë me kohë, për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite:

### Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2024.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes ankandit publik.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për rendin e ditës. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të miratohet rendi i ditës? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për pikën e procesverbalit. Pasi që nuk ka për debat: a jeni që të

miratohet procesverbali? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

**2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-dhjetor 2024**

**z.Berat Zuka, zyrtar për financa:** Përshendejte për të gjithë të pransihmit! Në mungesë të drejtoreshës, me autorizim të kryetarit jam caktu për me i preznatu raportin financar. Kemi përgatit në kohë raportin për kuvend dhe kemi dërgu në Ministrinë e Financave për shkak të legjislacionit dhe prezantimin e tyre tek Zyra Kombëtare e Auditimit. Raporti finacar i vitit 2024 korospondon me një shumë prej 15 milion e 623 mijë e 684 euro, kurse te faqja 2 ,buxhetin e aprovuar e kemi shumën prej 17 milion e 948 mijë e 944 euro. Do të thotë se te grandi qeveritar kemi një rritje prej 2 milion 344 mijë e 340 euro. Në shtator kemi pasë telashe me egzekutimin e pagave, që në fund qeveria me buxhetin shtesë për paga na e ka mbulu me 2 milion e 324 mijë e 430 euro. Të hyrat vetanke kanë qenë 1 milion e 29 mijë e 502 euro. Fondi burimor 22 i ndarë nëpër kategori ekonomike, bartja e mjeteve pa shpenzime organike 2023 si dhe rritje që ka qenë total bëjnë 454 mijë e 270 euro, dhe donacionet me një shumë prej 513 mijë e 762. Totali i buxhetit 19 milion e 945 mijë e 563 euro e 27 cent, ashtu sikur është i aprovuar në këtë shtesën me 2 milion e 324 mijë e 430 euro për pagat jubilare. Që nga tetori, nëntori dhe dhjetori janë mbulu edhe një pjesë e muajit shtator, pagat jubilare të arsimit që janë marrë është bërë dhe alokimi, çka do të thotë se, shpenzimi në grandin qeveritar kap një shumë prej 17 milion e 912 mijë e 606 euro e 74 cent. Të hyrat vetanake 1 milion e 8 mijë e 912 euro; të hyrat vetanake të bartura 449 mijë, si dhe donacionet që përfshinë edhe donacionet nga participimi i qytetarëve për te bujqësia dhe pjesa e Demosit dhe Unionit Europian, që janë bartë nga viti i kaluar, që do të thotë që buxheti total për paga dhe mëditje është 11 milion e 936 mijë e 439 euro e 22 cent, që do të thotë 99.95%. Ky buxhet deri me datën 27 ka qenë 100% i shpenzuar, mirëpo në datën 27 është bërë një kthim nga Drejtoria e Shëndetësisë për çështjen e lehonisë. Për këtë është që, aq sa kanë qenë të alokuara, aq kanë qenë të shpenzuara. Materialin e keni marrë me kohë, që të mos e zgjas më shumë, për çdo pakjartësi jam në dispozicionin tuaj.

**z.Jakup Demiri:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Tek shpenzimet janë diku mbi 2 milion euro të cilat i ka pru qeveria në fund të vitit për paga, dhe a ka borgje, dënime gjyqësore, a janë të gjitha këto për shkak të kontratës kolektive, dhe po shihet që është realizu buxheti mbi 99%, po sa borgje trashgohen këtë vit nga viti i kaluar, për mos pagesa të projekteve. Ka shumë kode që më interesojnë dhe dua që të përgatiten për në kuvend. Për secilin kod, që t'i kemi më herët për me mujtë me i analizu, se kur po na vijnë në kuvend, po është koha shumë e shkurt, 25.

**znj.Majlinda Shabani:** Përshendetje për të gjithë të pransihmit! Do të ishte mirë ky ekzekutim i buxhetit diku 100% kishte me qenë pak real, se për mu është pak e papranueshme ose absurde mënyra, tu i marrë parasysh edhe ato borxhe se veq kërkesa e vendimeve gjyqsore per qdo vitë shkonë tu rritë dhe realisht na dëmton si komun. Dua sqarim tek prezantimi i investimeve kapitale, ku kemi listën këtu. Dua më së pari me u specifiku këto projekte të cilat kanë qenë të parapamë për vitin 2024, sepse e dimë që ka projekte që janë 2-vjeçare që munden me zgjatë, mirëpo në bazë të përshkrimit shumë projekte që janë ndoshta qe 5-6 vite me të njëjtin emërtim. Tash nuk e dimë a jemi tu folë për këtë periudhë që i kemi bë këto investiume apo janë veç thjesht të përshkrume, edhe mandej si vazhdimësi. Muj edhe me i specifiku pjesën e investimeve, ku p.sh.: e ke rregullimin e ujësjellësit, që çdo seancë ne e kemi dhe që nuk mundemi me ditë specifikisht se në cilat pjesë është punu dhe çka është punu realisht. Rregullimi i hapësirave gjelbëruese është një emërtim që unë e shof qysh prej viti 2021 kur kam fillu në asamble, dhe tash nuk dimë se në cilat pjesë është tu bë ky rregullimi i hapësirave gjelbëruese. Mandej ke asfaltimin e rrugëve, hartimi i projekteve, dhe për këtë duhet me pru sqarim pak më të detajuar. Po në përgjethësi ky emërtim i projekteve, ky prezantimi analitik, është mirë me dhanë sqarime për projekte të cilat kanë qenë vazhdimësi, ato që janë 2 vjeçare dhe ato që janë projekte të reja. Sa i përket pasqyrave financiare, edhe unë kam disa kode që kisha kërku sqarim para seancës së kuvendin komunal. Shofë që në disa kode kemi pas ngritje të shpenzimeve. Janë diku 5-6 mijë, p.sh.: kemi kodin 13130, transportin për udhëtime zyrtare brenda vendit. Këtu ka rritje prej vitit paraprak diku 7 mijë euro. Dua ta di për cilat udhëtime zyrtare bëhet fjalë. Kemi rritje prapë, akomodimi për udhëtime zyrtare brenda vet kodit 13132, kemi rritje diku 8 mijë euro. Shërbime këshilldhënëse dhe profesionale, këtu është vlera 119.488. E di që ke me pas një sqarim, por prapë se prapë dua

një sqarim më të detajuar, se për mua ky shpenzim ka qenë pak absurd, se nuk po muj me kuptu çfarë shërbime këshilldhënëse dhe profesionale është dashtë me përfshi një shumë kaq të madhe. Blerja e librave dhe veprave artisitike është një shpenzim i ri, vlera është 20 mijë e 860, kodi 13510. Tjetra, 13511 pajisjet sportive dhe këtu dua informacion se në cilat shkolla janë furnziu me këto pajisje. Furnizme të pastrimit, kodi 13640. Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste 14022, dhe për kodin 13320.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshdentje për të gjithë të pranishmit! 3 çështje që i shtrove në fillim, që janë projekte të përsëritura, është fjala për hapësira gjelbëruese, asfaltimin e rrugëve rurale, për hartimin e projekteve. Në vazhdimësi ne kemi punu në hapësirat gjelbëruese. Në çdo vit kemi pas asfaltim të rrugëve rurale, prandaj është një kodë i cili titullohet, dhe përçdo vit kemi nevojë dhe kemi kompani e cila harton projekte për Komunën e Vitisë. Në rast se ke nevojë për më të detajuar, ne mundemi me i pru dhe shumë të tjerë të cilat përseriten që nga viti 2021, që je këshilltar i kuvendit komunal, bile aty ju e keni kërku, por a e dinë çka më kanë thanë këta të cilët ata të cilët përseriten, derisa nuk ka pranim teknik komuna ka obligim një pjesë dhe nuk e kemi qare pa e shti me e përsëritë si projekt, se tani nuk mund me bë pagesën e saj në momentin kur bëhet pranimi teknik.

**znj.Majlinda Shabani:** Për arsye të transparencës dhe me pa se ku janë tu shku këto investime, është mirë që të paktën me dhanë një informacion më të detajuar se kemi pas gjithmonë diskutime, se cilat lokalitete dhe cilat rrugë kanë qenë të përfshira në ato investime, cilat pjesë janë rregullu me hapësira gjelbëruese që qytetarët me i pa ato shpenzime a kanë shku aty. Mandej te ndërtimi i kanalizimeve, i ujësjellësit, asfaltimi i rrugëve, pajtohem me pjesën që duhet me pas investime dhe shumë mirë që ka investime.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Kemi projektin fllows, që jemi mundu shumë. Unë dhe Hidajeti një fat të mirë që kemi pas dhe njerëzit tanë, se fillimisht ka qenë një prjekt 800 mijë euro i ndamë për Komunën e Vitisë. Falë angazhimit tonë dhe të inxhinierëve të cilët kanë qenë aty dhe në plotni koordinimin me neve, na ka kalu një projekt që ka dalë në tender të hanën e kaluar me 6.5 milion euro. Aty është e përfshirë në radhë të parë një fabrikë për trajtimin e ujrave të turbullta që po nalet në Viti, është fabrika rezervarë dhe një pjesë për trajtimin e mbetjes së limit. Krejt këto janë në objekte të ndara. Unë thashë përsonat të cilët kemi qenë në rrjedh e kemi bë maksimumin pa e përjashtu kuvendin e cila ka pas mirëkuptimin në shpalljen me interes të përgjithshëm dhe në çështjen e shpronësimit të cilët së bashku me Hidajetin na e ka dhanë adresat ku duhet me prek, për me shpejtu edhe një fat të mirë që jemi një hapë para Gjilanit dhe Kamenicës. Sa i përket dokumentacionit, që me të vërtet këtë projekt, ta jetësojmë. Ende nuk po guxoj, megjithanë asgjë, edhe pse tenderi është shpallë deri të fillon puna, për shkak shumë zhgënjimeve shumëvjeçare të cilat i kam në atë drejtim, por do të ishte lajmi më i mirë për përfundimin e karrierës sime. Në rast se realizohet ai projekt për 6.5 milion euro, do të jem shum krenar për arritjet të cilët i kemi bë në atë drejtim. Pse po e themë këtë, se ne krejt buxhetin e komunës me pas shtjerr në 6.5 milion nuk kemi pas kapicete për me investu. Ky investim është i madh dhe është në rrugë të mbarë të realizmit. Ta shohim tash shqyrtimin e ofertuesve dhe dhashtë Zoti që ka muaji qershor të filloj puna. Nuk e kam bërë publike, dhe pse kanë insistu disa, tash e kam lëshu dhe një urdhëresë me pajisje, me leje të ndërtimit, që komuna jonë të mos jetë me asnjë fazë pengese për hapat. Kam thirrë inxhinierat e urbanizmit, për shkak që tash janë në hartimin e hartave zonale. Vetëm me urdhëresë munden me na urdhnu kryetari apo nënkryetari, dhe ju thashë që edhe atë përgjegjësi e marrë dhe e kam lëshu edhe atë urdhëresë që në të pajiset me leje ndërtimi, që ne si komunë mos t'i vonojmë për këtë investim shumë të madh, i cili është shumë i mirëpritur.

**z.Ilir Zuka:** Unë kisha dashtë që tek bartja e projekteve me pas parasysh që, me të vërtet ne kemi pas disa projekte prej 2019 deri 2024 të papërfunduara, që po barten, që po ekzistojnë në pasqyrat e në buxhet, dhe uroj që sivjet të kryhen. Edhe nënkryetar, ti e ceke ujin, shumë keq është Pozherani dhe 6 fshatra me ujë, edhe pajisjet e sanitarisë janë tu na u prishë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Ata çdo 15 ditë i bajnë analizat e ujit të Pozheranit. Për çudi analizat kur i bajnë del uji i pijshëm. Ne si shqetësim të qytetarëve të Pozheranit e qojmë në "Hidromoravë". Ajo e ka kontratën me entin higjenik të Gilanit, të cilët ata duhet me qenë të përgjegjshëm për ato analiza që i bajnë, deri sa për këto 5 lokalitete kemi pas me 2 vjet nuk kan guxu me marrë.

**z.Ilir Zuka:** Uji leje që nuk është për me pi, por edhe për larje, nuk jemi tu e përdor se është bërë bash i zi.

**znj.Majlinda Shabani:** Ndoshta jo rasisht është kjo kërkesë që ka qenë diku 6 milion, se po e shohim që nevoja për ujë ka qenë shumë e nevojshme për Komunën e Vitisë. Mua edhe më herët më ka interesu, por edhe vazhdimisht në disa raporte kur e ke pas me "Hidromoravën" kanë thanë që diku mbulueshmëria është 75%, që nuk ka qenë asnjëhere real. Nevoja ka qenë kjo, më së pari me u investu në infrastruktur të ujit, mandej me u rritë kapaciteti i ujit dhe të bëhet një zgjidhje që është dashtë me pritë disa vjet dhe shumë mirë që është bërë mundësia përmes kontratës fllows përmes komunës. Si do që të jetë, neve na intereson që ky problem me u zgjidhë, se është njëra prej temave që edhe neve si asamblist me thanë në secilën seancë kemi diskutu për çështje të ujit të pijshëm. Mos të folim për në aspektin e qeverisjes lokale, që ka qenë një poentim që sa kohë. Unë mendoj që është njëra prej projekteve më madhore që muj me thanë 20 viteve të fundit që ka ndodh në Viti, dhe uroj dhe shpresoj që ka me u realizu me sukses.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Raporti financiar që ka ardh, ky duhet me u lidhë me raportin e 9-mujororshit. Në raportin e 9-mujorshit i kemi diku 3 milion gati shpenzime gjyqësore. Këtu janë diku 600 mijë. D.m.th nuk përputhet raporti, nuk është real, se nëse vjen raporti i 9-mujorshit që shpenzimet gjyqësore janë 3 milion, tash janë 3 milion e 600, e këtu janë diku 600 e diqka mijë. D.m.th që nuk është në rregull, nuk perputhet. Ndërsa tjetra, po lidhem në bazë të faqes 4, investimet kapitale 3300. D.m.th 5199 mijë janë vendime gjyqësore që na ka marrë prej investimeve kapitale gjykata, ndërsa ne duhet me pas minus. P.sh.: ne duhet me mbetë borxh 519 mijë euro. Në qoftë se nuk i kemi realizu projektet këtu, d.m.th tek investimet kapitale na dalin 1 milion e 58 mijë euro na dalin obligime. Si na dalin obligime kur ne nuk i kemi të planifikume ato. Na dalin obligime 1 milion e 900 mijë, kur 500 mijë na ka marrë neve gjykata. D.m.th ne jemi mangët në investimet kapitale. Kjo d.m.th nuk tregon një përputhje reale të kësaj me këto që janë. Tek obligimet. Unë mendoj që kodi është dhe i kontratës kolektive. Janë edhe 2-3 milion obligime. Mendoj që edhe ato duhet me i qitë. Janë dhe do obligime, disa kontrata të nënshkrume për energji, dhe aty është një kontratë 3 milion euro. Janë edhe disa obligime tjera të shkollave. Unë mendoj që obligimet duhet me i qitë reale dhe unë mendoj që këto obligime nuk jan reale që janë paraqitë në letër dhe gjendjes si janë.

**z.Berat Zuka, zyrtar për financa:** Vendimet gjyqësore prej pagave janë marrë 2 milion e 671 mijë e 857 euro; prej mallrave dhe shërbime e komunali janë marrë 94 mijë e 115 euro e 80 cent dhe 150 euro; prej subvencioneve janë marrë 3212.52 euro, dhe prej vendimeve gjyqësore 591 mijë e 358 euro. Totali i të gjitha këtyre pagesave gjyqësore 3 milion e 293 mijë e 644 euro. 172 mijë 024 euro e 95 cent është shpronësimi i parceles të Agron Ahmetit me vendim të gjykatës janë marrë 1487 nga kompania "Hajrushi" për një vonesë të pagesës janë marrë 460.72 një faktur e humbur më herët nga "Euro print" dhe faktura prej 14724.55 euro është marrë nga pagesa e tatimit në pronë, përmbaruesi privat. Pjesën e parë e kemi pagu në vitin 2023, në 2024 na ka tradhtu se është bisedu që në fillim të vitit 2024 do të ja bajmë pagesën. Ne e kemi zotu kur kemi bë me shpronsu, mirëpo zotria nuk na ka pritë neve, ja ka dhanë tjetrit përmbarues. Na ka marrë në fillim të shpenzimeve këtë 14 mishin, paret na ka lanë neve, por na ka prishë atë strukturën e shpronësimeve, që do të thotë për të gjithë këto pagesa e kontratës kolektive çka rrjedhin nga shëndetësia kanë marrë pjesë edhe zjarrfikësit dhe arsimi. Shuma është 3 milion e 104 mijë e 946 euro. Është prezantu në faqen 30 faktura e obligimeve në mallra dhe shërbime, kemi shumën prej 544 mijë euro, shpenzime komunale 11736 euro, çka do të thotë janë të arsyeshme se fakturat e muajit 12 nuk kanë ardh këtu. Arsyetohet se deri me 12 dhjetor bëhet zotimi i mjeteve. Pas kësaj date ne kemi zotimin e ndalt dhe barten për pagesë gjithhere, kurse investimet kapitele që u ndërlidhën me herët është shuma prej 1 milion e 958 mijë e 776 euro. Këtu është se punëkryerësit kanë kry punë vullnetare. Sa e di unë, me projektues kanë pas në posedim fuqinë punëtore dhe mjeteve, mirëpo me kusht në fillim të vitit janë pagu gjitha këto pagesa, se i kanë pas kodet e projekteve shumëvjeçare. Shumica e këtyre projekteve janë pagu, subvencionet trafsere kanë qenë 22 mijë e 916 euro. Edhe këto janë pagu me fillim të vitit, mirëpo është e arsyeshme këtu se shuma për paga dhe mëditje neve na ka ardh si njoftim që nga viti 2024 ka mbetë dhe një vlerë prej 2 milion e 155 mijë euro. Kryetari dhe nënkryetari, dhe ne do ta kemi frustrim, se nga do ti marrim këto paga, me ligjin e buxhetit. Këtu thotë që, pagat vetëm të viti kalanderik të vitit 2025 do të paguhen, jo sikur më herët, dhe pjesa tjetër është mundësia që pjesa tjetër me na mbetë suficit e pagës. Çka na mbeten nëpër programe, nëpër punëtor që nuk punohet, mirëpo është shqetësim se nga do ti marrim 1 milion e 155 mijë euro. Këto çka kanë mbetë në fund të vitit 2024. Jemi tu bë përpjekje sa më shumë

shpenzimet dhe obligimet me i përfundu as kryetari as drejtoresha as ne nuk e dimë rrugën se ngado t'i sigurojmë këto mjete, veç nëse na jepet mundësia sikur vitin e kaluar që mos me na u prishë neve struktura e fakturave.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Tash po i bjen që kan kry punë më shumë për 1.5 milion euro punëkryersit.

**z.Berat Zuka, zyrtar për financa:** Jo më shumë e kanë pas buxhetin e sigurt nga kuvendi komunal. Në ato projekte i kan kry punët ata, por kanë pas dëshminë, mirëpo nuk kemi të drejtë ato faktura mos me i dërgu te përmbaruesi privat. Ato punë të 500 mijë euroshit nuk jan kry ato punë janë marrë nga projkete të vogla që i kemi pasë shumica e projekteve të reja janë anulu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Prej shpenzimeve kapitale të përgjithshme çka i kemi pas të planifikume prej kuvendit 519 mijë euro na ka marrë gjykata. Këtu po del që prej investimeve kapitale janë kry punë 1 milion e 900 mijë më shumë. Tash ne kemi parë edhe 500 mijë. D.m.th 1.5 milion janë jashtë planifikimit.

**z.Berat Zuka, zyrtar për financa:** Këto janë projekte shumvjeçare që kanë qenë projekte në vitin 2025 dhe ato faktura kanë qenë prej departamentit të thesarit që obligohet komuna që i kanë në fundvit bëni kërkesë në thesar, se po i mbulon qeveria se kanë pas një fond shtesë, dhe ne kemi mëndu që edhe ata do ta kenë një mundësi. Ne kemi bërë kërkesë, por asnjë projekt nuk ka kalu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne po flasim për 31.12. Na ka përcjell kjo gjendje 500 mijë euro çka janë kanë për investime kapitale, tjerat kanë shku në rregull. 500 mijë na ka marrë gjykata, ne kemi 2 milion borxhe, d.m.th 500 mijë i ka marrë gjykata, por 1.5 milion është e 2025-ës që je ti pagu ato e këto janë kanë të 2024-ës.

**z.Berat Zuka, zyrtar për financa:** Po, 2024, se i kanë kry punët para kohe me kontratën shumëvjeçare. Për atë punë është Zyra e Menaxhimit të Projektit me punëkryersit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim kjo pikë shkon për në kuvned.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronën komunale përmes ankandit publik**

**znj.Hidajete Aliu, udhëheqëse në Drejtorinë e Kadastrit:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Drejtoria jonë ka përgatit një propozim për dhënie në shfyrtezim të pronës komunale përmes ankandit publik. Kjo pronë jepet me afatshkurt prej 15 viteve. Pjesa e parcelës është 300 metra katror jepet në shfrytëzim. Kjo tokë është tokë bujqësore e klasit të 5-të. Që mos ta zgjas më shumë, nëse keni ndonjë pyetje shtesë jam në dispozicionin tuaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pse do të jepet në shfrytëzim kjo pronë.

**znj.Hidajete Aliu, udhëheqëse në Drejtorinë e Kadastrit:** Tokë bujqësore ka qenë kërkesë e një qytetari.

**z.Ilir Zuka:** A ka qenë e parapamë në listë për dhënie në shfrytëzim?

**znj.Hidajete Aliu, udhëheqëse në Drejtorinë e Kadastrit:** Po është e parapamë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Çfarë përfitimi ekonomik ka parapa komuna në këtë zonë prej 3 ari.

**znj.Hidajete Aliu, udhëheqëse në Drejtorinë e Kadastrit:** Tokë bujqësore që është parapa të jepet në shfrytëzim dhe pala ka bërë kërkesë.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Ky e ka problemin qe 15 vite, problemin me ujë dhe ky e ka për me qelë një bunar. Ka bërë shumë herë dhe ne kemi qenë të obligum me inicu këtë pronë në kuvend. Ka qenë shumë here edhe në televizion. Unë jam propozu edhe në televizion.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë mendoj që nuk ka ligj që lejon për me hapë bunar.

**z.Ilir Zuka:** A kemi ne si detyrë si institucione komunale me ja siguru ujin. Jo me bajtë që 15 vite me kofe prej posht me dergu nalt.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Kërkesen e ka bë moti. Këto janë obligativ kërkesën me e procedu. Kuvendi është ai që e vendos.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ti je institucion, Hidajeti është institucion. Hidajeti e dinë a ka ligj me dhanë këtë për me hapë bunar për ujë. Nëse nuk ka ligj ti me vetëdije je te shkel ligjin si institucion, se neve në kuvned po na bjen në dokument me dhanë në shfrytëzim pronë bujqësore. Ne mendojmë që ai është tu mbjellë diçka, po 3 ari ai nuk bënë asgjë.

**znj.Majlinda Shabani:** Qe sa jemi tu dhanë prona në shfrytëzim, për arsye të ndryshme që nuk e dimë as për çka jemi tu dhanë. Tash është në pyetje kjo arsyeshmëria dhe kjo qenka e vetmja formë me bë zgjidhje për këtë problem, është që me marrë me shfrytëzu atë pronë me të mbjellura bujqësore, përderisa ti si komunë jep disa prona publike që nuk e di as për çka shfrytëzohen. Tash me kap me kqyrë e me tjerrë këtë rast disi po më duket pak jo bash bash mirë.

**z.Ilir Zuka:** Është një djalë shumë institucional, ai ka mujtë me hapë sikur e kan hapë dhe 4-5 tjerë dhe nuk ish marrë askush me atë punë. Gjithashtu edhe në Trestnik janë mbi 40 bunare të hapur në kodër. Ky ka kërku veç në mënyrë institucionale.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nëse ai e bënë të paligjshme është ndryshe, se ti je institucion, e jep me vetëdije me kuvend me drejtori, pe qonë gishtin në mënyrë të paligjshme me vetëdije.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Hidajeti mund me shkru aty për shfrytëzim, aspekt bujqësor dhe ujë të pijes e kthen ministria. Është me rëndësi ne me kry obligimin, se kërkesën ai e ka.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka më për debat: a jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? Pra, me të gjitha votat pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katër e rendit të ditës:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Prezenton pikën e katër të rendit të ditës dhe hap debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu që kjo pikë e rendit të ditës të shkon për në kuvend. Ju faleminderit për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPF-së.

Mbledhja përfundoi në ora 11:10

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

______________

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

______________

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Pranuar-Primljeno Me-Dana 10-03-2025
Nr. I organit Org. Broj 02- | Nume. Broj 035/02- | Shtojce Prilog | Vlera Vrednost 000

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40, të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28, qershor 2008) dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.2, neni 8 paragrafi 1 pika 1.2 lidhur me neni 14, të Ligjit me nr. 06/L-092 , Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës ( Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019) neni 5 paragrafi 1 pika 1.3 neni 6 dhe 13 të Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës dhe neni 50 paragrai 1 shkronja l), të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës me datën 10.03.2025, bënë këtë :

# PROPOZIM VENDIM

## Paraprak për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale përmes procedurës së shprehjes së interesit

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim paraprak, propozohet të **jepet pëlqimi** për dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshëme të Komunës së Vitisë , në shfrytëzim afatgjatë përsonave fizik dhe juridik deri në 20 vite , për përpunimin e mbeturinave, respektivisht shfrytëzimin për energji të rinovushme, përmes procedurës së shprehjes së interesit.

Neni 2.

Prona e palujtëshme për dhënjen në shfytëzim , sipas nenit 1 të këtij propozim –vendimi janë:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101003-01607-2, në zonën kadastrale në Binçë, në vendin e quajtur Malishte , me kulturë tokë tjeter jo pjellore , pjesen e sipërfaqës prej 20000 m$^2$ nga sipërfaqe e përgjithshëme e cila ka 32552 m$^2$, e evidentuar sipas çartifikatës së pronës në posedim të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Qellimi i dhenjës në shfrytëzim të pronës komunale është Interesi Publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 4.

Procedurat për dhënjen e pronës së palujtshme komunale në shfrytëzim afatgjat realizohet përmes shprehjes së inereit, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092, Për Dhënjen në Shfrytëzim dhe Kembim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe Rregullorës (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënjës në Shfrytëzim dhe Kembimin e Pronës së Palujtëshme të Komunës.

Neni 5.

Për zbatimin e këtij propozim – vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës , Zyra Administratës, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria e Financave të komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
KRYETARI

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

